



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.1211 Prot.

Tiranë, më 30 .10. 2023

**V E N D I M**

**Nr. \_219\_ , Datë \_30.10. 2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.54 Regj, datë 04.04.2023, paraqitur nga z.A.Gj kundër Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave, me pretendimin se është diskriminuar për “çdo shkak tjetër”, si i burgosur politik .

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi A.Gj, i datëlindjes 03.10.1970, parashtron se ka qënë i burgosur në bazë të Vendimit nr.404, datë 15.10.1986 dhe ka kryer 5 vite burg në vitet 1986-1990 në burgun Qafë-Bari të Pukës. Gjatë kohës së dënimit ka punuar në minierën e burgut.

Sipas ankuesit, Gjykata e Strazburgut në vendimet e saj ka theksuar se, personat te cilët kanë kryer burg dhe kanë punuar të detyruar në ato vite, i takon të marrin pension të parakohshëm dhe se një e drejtë e tillë përcaktohet në nenin 4 të Konventës për ndalimin e skllavërisë dhe punës së detyruar. Ankuesi shpjegon se, në vitet 2010-2018 ka marrë 8 këste në total, 23 milion e 600 mijë lekë të vjetra për 4 vite e 5 muaj burgim. Pas vitit 2018 e në vijim nuk ka marrë asnjë këst tjetër.

Në mars të vitit 2023, ankuesi informon se i është drejtuar me shkresë Kryeministrisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, që t’i krijohej mundësia për të marrë pension të parakohshëm dhe pagesat që nuk ka marrë për vitet e tjera, por ka marrë përgjigje negative.

Ankuesi pretendon se persona të tjerë që ka patur në burg, si Sherif Merdani, Fatos Lubonja, Spartak Ngjela, Sajmir Maloku, por edhe të tjerë, marrin pension të parakohshëm.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e pensionit të parakohshëm.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtpërdrejtë nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga ankuesi, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi ose mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë ose privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 476/1 prot., datë 20.04.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave, në cilësinë e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.

1.1 Me shkresën nr. A-449/1 prot., datë 03.05.2023, Ministria e Drejtësisë (në vijim MD), ktheu përgjigje duke depozituar dokumentacionin e kërkuar. Ndër të tjera në parashtrimet e sjella nga MD, kjo e fundit parashtron:

*Së pari*, nga verifikimet e kryera në sistemin e dosjeve të regjistruara brenda afateve ligjore dhe në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, rezulton se, kërkesa për dëmshpërblim është regjistruar në dosjen me nr.4801, datë 27.03.2008, në emrin e A.A.Gj, kategoria burg, miratuar me VKM nr.1699, datë 29.12.2008, me listën nr.1, në shumën 2.368.603 lekë.

*Së dyti*, rezulton se MD, me shkresën nr.A-334/1 prot., datë 16.03.2023 dhe shkresën nr. A-334/3 prot., datë 11.04.2023, i ka kthyer përgjigje shteruese dhe sqaruese shtetasit A.Gj, në lidhje me ecurinë dhe procesin e përlllogaritjes së dëmshpërblimit, duke e informuar mbi masën përfundimtare, pasi pretendonte gabime në përlllogaritje. Po ashtu, në zbatim të nenit 23, e në vijim të ligjit të sipërcituar nr.9831/2007, i ndryshuar, dosja e mësipërme, ka kaluar një proces shqyrtimi, verifikimi dhe bashkërendimi me institucionet që ligji i ngarkon në verifikimin e të dhënave, me qëllim përcjelljen e informacionit të plotë MD, për çdo ish të dënuar politik të regjimit komunist.

*Së treti*, për sa i përket pagesës së kësteve të dëmshpërblimit, në referim të nenit 13, të ligjit nr.9831/2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, ky proces realizohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, institucion i cili verifikon dhe përcakton trashëgimtarët përfitues, si dhe kryen shpërndarjen e dëmshpërblimit. MD realizon shqyrtimin administrativ të kërkesave, duke verifikuar aplikantët nëse legjitimohen ose jo në kërkesën e tyre. Sa i përket verifikimeve që lidhen me trashëgimtarët përfitues të dëmshpërblimit financiar apo pagimin e kësteve të dëmshpërblimit, kjo procedurë është në kompetencë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Masa e dëmshpërblimit përfundimtar është përlllogaritur si pasojë e zbritjes së shumave përfituar me ligje të mëparshme, sipas verifikimeve të kryera nga institucionet në të cilat MD bashkërendon punën.

Sipas dokumentacionit të përcjellë, rezulton se shtetasi ka vuajtur 4 vjet, 4 muaj dhe 9 ditë, për veprën penale politike “*Tradhti ndaj atdheut*” dhe atë jo politike “*Sjellje e padenjë në shoqëri*”. Kështu, me Vendimin nr.404, datë 15.10.1986, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dënuar me 5 vjet sipas nenit 47/gj, për veprën penale politike “*Tradhti ndaj atdheut*” dhe me 6 muaj për veprën penale jo politike “*Sjellje e padenjë në shoqëri*”, sipas Kodit Penal të vitit 1977.

Me shkresat e përcjella pranë institucionit tonë, është proceduar duke konsideruar masë të zbritshme vlerën e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe duke konsideruar formulën e përlllogaritjes për veprën penale jo politike, konkretisht:

$$\Delta = (A/\Sigma) \times Y$$

A	Dënimi Politik	-	5 vjet = (5 x 365) = 1825 ditë
Σ	Dënimi Politik dhe Jo Politik	-	5 vjet + 6 muaj = (1825 + 186) = 2011 ditë
Y	Dënimi i vuajtur konkretisht	-	4 vjet 4 muaj 9 ditë = (4 x 365) + (4 x 31) + 9 = 1593 ditë

$$\Delta = A/\Sigma \times Y \quad (1825/2011) \times 1593 = 1445 \text{ ditë}$$

1445 ditë x 2 000 lekë = 2.892.000 lekë, masa e dëmshpërblimit (pa masat e zbritshme)

-Ndërkohë, rezulton 523 397 lekë, shuma e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përkatësisht 0 lekë në të holla dhe 523 397 lekë në letra me vlerë)

- 0 lekë, rezulton shuma e paraqitur nga Enti Kombëtar i Banesave dhe ish ZQRPP, aktualisht ASHK.

2.892.000 lekë, masa e dëmshpërblimit – 523. 397 lekë nga MFE = **Përfundimisht 2.368.603 lekë.**

Kuadri ligjor që rregullon trajtimin me skemë pensioni për ish të dënuarit politikë të cilët gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit kanë punuar në miniera nëntokë, është ligji nr.24/2018 “*Për disa shtesa në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar*”. Sqarojmë se, në referim të ligjit të sipërcituar, vërtetimi për kohën e vuajtjes së dënimit në burgjet kur punohej në minierë në nëntokë lëshohet nga Ministria e Brendshme, pas konfirmimit nga MD. Aspektet proceduriale të kuadrit ligjor në fuqi i japin tagra MD, vetëm të konfirmojë për MB, sa i përket hyrje-daljeve nga burgu, si dhe informacionin për dënimet dhe veprat penale për të cilat është dënuar, kjo e fundit më pas lëshon vërtetimin dhe përcjell informacionin drejt Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH). Theksojmë se, kuadri ligjor i cituar, trajton vetëm ish të dënuarit, të cilët kanë vuajtur burg për arsye politike dhe gjatë kësaj kohe kanë punuar në minierë. Në referim të ligjit nr.24/2018, orientojmë shtetasin që t’i drejtohet ISSH-së ku ka vendbanimin, që të paraqesë kërkesën për vërtetim, për trajtimin me skemë pensioni për ish të dënuarit politikë, në MB.

Si përfundim, MD, thekson se ka përmbushur detyrimin e vet ligjor në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “*Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist*”, i ndryshuar.

1.2 Këshilli i Ministrave nuk depozitoi pranë Komisionerit parashtrime në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ankuesi.

2. Në datën 10.05.2023, ankuesi ka paraqitur kundërshtimet e tij (protokolluar me nr.476/3 prot) në lidhje me qëndrimin e mbajtur si më sipër nga MD, duke parashtruar ndër të tjera se:

Në rrethanat aktuale, si ish i burgosur në regjimin komunist, si ish i dënuar politik, ankuesi pretendon se po i mohohet një e drejtë që ia jep ligji në sistemin pluralist dhe demokratik. Ai pretendon se, ligjet dhe VKM-të vrastare të vitit 2007-2009, të miratuara nga qeveritë, janë diskriminuese dhe kanë shkelur çdo moral njerëzor.

Ankuesi shpjegon se, në vitin 1986, kur ai është dënuar për krime politike gjatë regjimit komunist ka qenë i mitur, një fëmijë 15 vjeç dhe në mënyrë çnjerëzore është skllavëruar në burg dhe ka punuar në minierë për 5 vjet. Sipas tij, edhe në regjimin komunist, një person minore nuk mund të dënohej për krime kundër pushtetit. Sipas ankuesit, Kodit Penal në fuqi në kohën që ai është dënuar për veprën politike, armik kundër pushtetit popullor, arratisje, parashikuar nga neni 47 i K.Penal, nuk ka patur parashikime për dënimin e të miturve, por moshë e dënimit për këtë krim ka qenë 18 vjeç. Në kohën që ai është dënuar, gjyqtarë, hetues dhe oficerë të sigurimit kanë shkelur hapur “Konventën e minorenit” duke e dënuar atë për një krim politik edhe pse ishte minore. Sipas ankuesit, referuar dosjes së tij, ai është dënuar me dy dënime, një me 10 vjet dhe një me 5 vjet. Në mënyrë të padrejtë ankuesi pretendon se i janë përlllogaritur 4 vite 4 muaj e 9 ditë, duke iu zbritur 7 muaj e 21 ditë, të cilat janë gjaku i tij, pasi i kanë marrë lirinë, e kanë skllavëruar me tortura çnjerëzore, ka punuar fëmijë në galeri me tre turne, në të ftohtë me minus 25 gradë, duke mbushur vagonat me 15-20 tonë në ditë. Me papërgjegjshmëri morale i janë ulur 6 muaj, ndërkohë që ka vuajtur në burgun me famëkeq të regjimit komunist në Shqipëri, atë të Qaf-Barit.

Ankuesi parashtron se, ai duhet të përfitojë dëmshpërblim për 10 vite, e përlogaritur me 20 mijë lekë dita dhe shteti duhet t'i paguajë 76 milion e 400 mijë lekë të vjetra, pasi në bazë të llogaritjeve juridike dhe ekonomike të bëra nga institucioni ndërkombëtar i skllavërimit, është 5+5 e barabartë me 10 vjet burg, 5 vjet burg i ka bërë ditë më ditë, dhe sipas Kodit Penal janë 10 vjet burg si minoren.

Ankuesi pretendon gjithashtu se, duhet të përfitojë pension të parakohshëm që marrin të tjerë ish të burgosur politikë (janë mbi 40 persona të tillë) në vlerën 780 mijë lekë të vjetra në muaj.

Në mënyrë të padrejtë ish diktatorët që kanë persekutuar personat gjatë regjimit komunistë janë shpallur të pafajshëm nga gjykatat dhe të tjerë persona të regjimit komunist kanë marrë statusin si të burgosur politikë dhe janë dëmshpërblyer si të pafajshëm me 50 dollarë ditën. Në vitet 2000-2002 ata janë likujduar të gjithë dhe sot marrin pensione mbi 1 milion lekë. Ish spiunat, oficerë të sigurimit të shtetit që kanë persekutuar, sot marrin pension mbi 800 mijë lekë në muaj dhe kanë statusin e oficerit. Ndërsa personat që janë skllavëruar gjatë regjimit komunist përfitojnë një dëmshpërblim prej 20 mijë lekë në ditë.

Ankuesi kërkon zbatimin e ligjit me barazi dhe ai të përfitojë dëmshpërblim për 10 vite, pasi 5 vjet burg të bëra si minoren përlogariten sa dyfishi pra 5+5, përlogaritur me 20 mijë lekë në ditë, duke i akorduar atij një dëmshpërblim prej 76 milion e 400 mijë lekë të vjetra, si dhe të përfitojë pensionin e parakohshëm në masën 780 mijë lekë të vjetra në muaj. Në këtë mënyrë sipas tij ai mund të barazohet me persekutorët.

Ankuesi parashtron se, sipas nenit 4, të Konventës Europiane të Minorenit, genocidi, skllavërimi i fëmijve, torturat çnjerëzore, janë krime që nuk parashkruhen, janë të dënueshme nga Gjykata e Strasburgut dhe shteti penalizohet me miliona euro për ta dëmshpërblyer.

3. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 07.07.2023, në orën 10.00.

Seanca dëgjimore e datës 07.07.2023, u zhvillua me pjesëmarrjen e ankuesit A.Gj, i cili ishte personalisht prezent dhe Ministrisë së Drejtësisë, e përfaqësuar në seancë dëgjimore nga z. Xh.K dhe z.A.P, të pajisur me Autorizimin nr.A-449/3 prot., datë 04.07.2023, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë.

Gjatë seancës dëgjimore palët i qëndruan të njëjtave parashtrime të depozituara paraprakisht nëpërmjet komunikimit shkresor.

4. Me shkresën nr. 929 prot., datë 08.08.2023, Komisioneri iu drejtua Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) me një kërkesë për informacion, në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- A mund të jetë përfitues sipas parashikimeve të nenit 1, të ligjit nr.24/2018 “Për një shtesë në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, shtetasi A.Gj, i datëlindjes 03.10.1970, i cili rezulton të ketë vuajtur dënimin si ish i dënuar politik në Repartin e Riedukimit 311, Qafë Bari, ku punohej në minierë?
- Nëse po, në cilin moment i ka lindur apo i lind kjo e drejtë, dhe cila është procedura që duhet të ndjekë ky shtetas për të përfituar sipas këtij parashikimi ligjor?
- Nëse jo, cila është arsyeja apo kushtet që pengojnë këtë shtetas, që të përfitojë sipas parashikimit të mësipërm ligjor?

5. Me shkresën nr.6165/3 prot., datë 17.08.2023, ISSH, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion të dërguar nga Komisioneri, duke parashtruar ndër të tjera se:

Lidhur me pyetjen nëse z. Gj mund të jetë përfitues sipas parashikimeve të nenit 1, të ligjit nr.24/2018 “Për një shtesë në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, ISSH, bën me dije se:

Ligji nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, sipas nenit 3 të tij, parashikon se personat që kanë punuar në miniera në nëntokë janë përfitues nëse plotësojnë këto kushte: Mosha 55 vjeç dhe periudhë e përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat, jo më pak se 12 vjet e 6 muaj, në proces pune në miniera, në nëntokë. Sipas nenit 1, të ligjit nr.24/2018, periudha e vuajtjes së dënimit të ish të dënuarve politikë në burgjet ku punohej në minierë nëntokë, për efekt pensioni, llogaritet sa dyfishi i periudhës së qëndrimit në këto burgje.

Z. Gj, nëse nuk plotëson kushtet për përfitim sipas ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, mund të jetë përfitues sipas parashikimeve të nenit 1, të ligjit nr.24/2018 “Për një shtesë në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, pasi të ketë plotësuar kushtet ligjore sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku sipas nenit 31, të këtij ligji, parashikohet se, personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurimi shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji, i cili për burrat parashikon moshën 65 vjeç.

Z. Gj, nëse plotëson kushtet për pension pleqërie sipas ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, i lind e drejta për përfitim sipas parashikimeve të ligjit nr.29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, duke përfituar shtesë mbi pensionin e pleqërisë në momentin e plotësimit të moshës për pension pleqërie, sipas nenit 92, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar.

Sipas nenit 3, të ligjit të sipërcituar, përfituesit duhet të kenë periudhat e punës të kryera në miniera në nëntokë, sipas dispozitave të krerëve I, XIII e XIV, të pasqyrës nr.1, të VKM-së nr.526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar dhe sipas nenit 6,

shtesën mbi pension e përfitojnë të gjithë ata persona që kanë jo më pak se 6 vite në profesionet dhe punët e përcaktuara në këtë ligj.

ISSH, informon se me kërkesën nr.5881 prot datë 26.08.2022, ankuesi i është drejtuar këtij institucioni duke kërkuar përfitimin e trajtimit me pension të posaçëm. Me shkresën r.6165/1 prot, datë 26.07.2023, ISSH ka sqaruar ankuesin lidhur me kushtet e përfitimit dhe procedurën për dhënien e pensionit të posaçëm, të cilat përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, ndërsa administrimi bëhet nga ISSH.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Bazuar në informacionin dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar sa më poshtë:

Ankuesi A.Gj, është i datëlindjes 03.10.1970, lindur dhe banues në Tiranë. Me Vendimin nr.404, datë 15.10.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dënuar për krimin e “Tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit ngelur në tentative”, në bazë të germës “gj” të nenit 47, të Kodit Penal të vitit 1977 dhe është dënuar me 5 vjet heqje lirie, si dhe për krimin e “Sjelljes së padenjë në shoqëri”, në bazë të nenit 129 të Kodit Penal të vitit 1977 dhe është dënuar me 6 (gjashtë) muaj heqje lirie. Në bashkim të dy dënimeve, përfundimisht gjykata e ka dënuar ankuesin me 5 (pesë) vjet heqje lirie. Në kohën e kryerjes së veprave penale, ankuesi ka qenë në moshë të mitur, pa i mbushur 16 vjeç. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr.272, datë 18.11.1986.

Referuar shkresës “*Kthim përgjigje*” me nr.A-474/2 prot datë 22.05.2020, të Ministrisë së Brendshme, konfirmohet se, “...në referencën arkivore AMB, Fondi nr.1 (Hetimor-Gjyqësor), pas konfirmimit dhe nga Ministria e Drejtësisë, për shtetasin A.A.Gj, i vitlindjes 1970, ndodhen këto të dhëna. Është arrestuar në datë 06.08.1986. Gjykata e Rrethit Tiranë me vendimin nr.404, datë 15.10.1986, ka deklaruar fajtor të pandehurin A.Gj, për veprën penale politike “Tradhti ndaj Atdheut”, e dënon me 5 (pesë) vjet heqje të lirisë dhe për veprën penale jopolitike “Sjellje e padenjë në shoqëri” e dënon me 6 (gjashtë) muaj heqje të lirisë. Dënimin e ka kryer deri në datën 15.12.1990 në Repartin e Riedukimit 311 Qafë-Bari, ku punohej në minierë.”

Në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, ankuesi ka paraqitur brenda afateve ligjore kërkesën për dëmshpërblim, e cila është regjistruar në dosjen nr.4801, datë 27.03.2008. Dosja e ankuesit pasi ka kaluar në proces shqyrtimi dhe verifikimi në themel, me Urdhrin nr. 4801/9, datë 07.09.2009, të Ministrisë së Drejtësisë është urdhëruar: “Pranimin e kërkesës së kërkuesit A. A.Gj për dëmshpërblimin financiar si ish i dënuar politik në masën 2 368 603 lekë, për kryerjen e dënimit politik të padrejtë me burgim për veprën penale politike “Tradhti ndaj atdheut në formën e

*arratisjes e mbetur në tentativë” të parashikuar nga neni 47/gj i K.P të vitit 1977. Kjo vepër penale konsiderohet politike për efekte të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, sepse është e listuar në gjermën “dh” të nenit 5 të tij.”*

Bazuar në aktet e administruara, ankuesi deklaroi se ka përfituar 8 (tetë) këste, në një shumë totale prej 23 680 000 lekë. Me pretendimin se, dëmshpërblimi i tij është përlogaritur gabim ankuesi ka paraqitur pranë Ministrisë së Drejtësisë kërkesën e cila është regjistruar me nr.A-334 prot, datë 08.03.2023. Me shkresën nr. A-334/1 prot, datë 16.03.2023, Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke e sqaruar se, përlogaritja është bërë konform parashikimeve ligjore dhe se Ministria e Drejtësisë e kishte përmbushur detyrimin e saj ligjor në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar.

Mbi bazën e kërkesës së ankuesit, Instituti i Ish të Përndjekurve Politikë, me shkresën nr.300 prot, datë 30.03.2023, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me një kërkesë në lidhje me gjendjen e dosjes së ankuesit, meqënëse ankuesi kishte ngritur pretendime se dëmshpërblimi i tij nuk ishte llogaritur në mënyrë të saktë. Me shkresën nr.A-334/3 prot, datë 11.04.2023, Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje Institutit të Ish të Përndjekurve Politikë, duke bërë sqarimet përkatëse në lidhje me rastin e ankuesit.

Bazuar në dokumentacionin e administruar rezulton se, ankuesi i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore me një kërkesë, e cila është regjistruar me nr.5881 prot., datë 26.08.2022, lidhur me përfitimin e trajtimit me pension të posaçëm. Me shkresën nr.6165/1 prot., datë 26.07.2023, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke e informuar në lidhje me kuadrin ligjor që rregullon përfitimin e pretenduar prej tij, si dhe duke e bërë me dije ankuesin se, ISSH, zbaton dhe administron vendimin e miratuar nga Këshilli i Ministrave për dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror, në shumën dhe në kushtet e përcaktuara.

Rezulton gjithashtu e provuar se, ankuesi i është drejtuar Platformës së Bashkëqeverisjes. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 23.03.2023, kjo Platformë i ka kthyer përgjigje ankuesit duke i komunikuar përgjigjen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përgjigje e cila rezulton të jetë e njëjtë me atë të shkresës së sipërcituar.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr.54, datë 04.04.2023, në të cilën pretendon se është diskriminuar për “*çdo shkak tjetër*” si i burgosur politik, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave.

Bazuar në pretendimet e parashtruara nga ankuesi gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, rezulton se pretendimet e ankuesit konsistojnë në dy momente. *Së pari*, ankuesi pretendon se dëmshpërblimi financiar si ish i dënuar politik në regjimin komunist është përlogaritur gabim dhe *së dyti*, ankuesi pretendon se i është mohuar e drejta për të përfituar pension të posaçëm shtetëror.



Gjatë regjimit komunist në Shqipëri, me mijëra njerëz janë pushkatuar, burgosur dhe përndjekur për arsye politike. Të burgosurit dhe të përndjekurit politikë kanë qenë të detyruar të jetojnë në kushte tepër të vështira. Trajtimi i tyre në atë kohë konsiderohet sot si diskriminues dhe antinjerëzor. Për shkak të këtyre kushteve, shumë prej tyre edhe kanë vdekur, janë gjymtuar ose kanë marrë sëmundje të ndryshme shpeshherë të rënda dhe të pashërueshme. Një jetë me mjaft probleme e vështirësi shoqëronte pothuajse gjithnjë edhe familjarët dhe të afërmit e tjerë të të pushkatuarve, të burgosurve dhe të përndjekurve politikë. Shpesh, ata internoheshin dhe detyroheshin të punonin në punë të rënda dhe të dorës së dytë, i sekuestrohej një pjesë e mirë e pasurisë, përjashtoheshin nga pjesëmarrja apo veprimtari të rëndësishme shtetërore e shoqërore, u mohojeshin shkollimi i lartë, privoheshin edhe nga shumica e atyre pak lirive dhe të drejtave që deklaronte legjislacioni i asaj periudhe, etj. Marrë në tërësi, burgosjet, ekzekutimet pa gjyq, torturat, trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor ose degradues, deportimet dhe diskriminimi sistematik ndaj kësaj kategorie njerëzish, konsiderohen si shkelje të rënda të lirive dhe të drejtave të njeriut<sup>3</sup>.

Gjykata Kushtetuese,<sup>4</sup> në vendimarrjet e saj kur ka trajtuar çështje që kanë patur të bëjnë me dëmshpërbimin dhe kompesimin e ish të burgosurve dhe të përndjekurve politike, ka theksuar se, kjo e drejtë nuk mund të trajtohet si një e drejtë subjektive. Gjykata Kushtetuese, është shprehur se, shteti demokratik i dëmshpërblen e kompenzon këta persona sipas kushteve e mundësive ekonomike e financiare, duke u bazuar kryesisht në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe të barazisë. Parimi i drejtësisë, në thelb, kërkon të merren në konsideratë edhe interesat e anëtarëve të tjerë të shoqërisë, si dhe interesi publik në tërësi. Është e pamundur të eliminohen të gjitha padrejtësitë e shumta e të thella të bëra në vite ndaj këtyre personave nga regjimi komunist. Synim kryesor duhet të jetë zvogëlimi sa më shumë i pasojave të këtyre padrejtësive. Nga ana tjetër, parimi i barazisë kërkon ndalimin e diskriminimit dhe trajtim të barabartë në të drejta të të gjithë viktimave të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjej trajtimi ndryshe i kategorive të caktuara të personave që përfitojnë nga kjo e drejtë. I tillë mund të ishte rasti i diferencimit në trajtim i personave që kanë vuajtur më gjatë dhe më shumë në burgjet e regjimit komunist, diferencimi për shkak të moshës, diferencimi i të afërmeve të personave të vdekur ose të pushkatuar për arsye politike, etj. Megjithatë, ajo që ka rëndësi të theksohet është se në këtë rast, parimi i barazisë “... nuk do të thotë që të gjithë ata duhet të marrin të njëjtën shumë në para, por që të gjithë duhet të përfitojnë njëlloj të njëjtat të drejta, brenda hapësirës që përcakton ligji”. Gjykata Kushtetuese thekson se, dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, duhet të kenë njëkohësisht vlerësim simbolik dhe financiar. Dëmshpërblimi dhe kompensimi në tërësi duhen kuptuar si detyrime pozitive të shtetit për të marrë masat e duhura që lehtësojnë sa më shumë rehabilitimin dhe riintegrimin e kësaj kategorie njerëzish në shoqërinë shqiptare.

Çështja e dëmshpërblimit dhe e kompensimit të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë ka filluar të trajtohet ligjërisht në vitin 1991. Në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, në pjesën hyrëse të tij, theksohet detyrimi i Qeverisë për “... të marrë të gjitha masat që të kompensojë dhe rehabilitojë të gjithë

<sup>3</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 34, datë 20.12.2005.

<sup>4</sup> Si më sipër.

personat që janë akuzuar padrejtësisht për shkelje për të cilat bën fjalë ky ligj dhe të sigurojë për ta, me përparësi, ndihmën materiale dhe morale për t'u riintegruar plotësisht në shoqëri". Më pas, çështja e dëmshpërblimit dhe kompensimit pasuror të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, pavarësisht se buron nga ligji nr.7514, datë 30.9.1991, i ndryshuar u rregullua në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 "*Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist*", të ndryshuar. Me vendimin Nr. 34, datë 20.12.2005, Gjykata Kushtetuese, shfuqizoi si antikushtetues, nenin 1, të ligjit nr.9260, datë 15.7.2004 "*Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist"*", i ndryshuar, i cili synonte të rregullonte mënyrën e përlllogaritjes së dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist.

Në vitin 2007, u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 "*Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politike të regjimit komunist*", i cili është aktualisht në fuqi. (në vijim ligji nr.9831, datë 12.11.2007) Qëllimi i këtij ligji është dhënia e dëmshpërblimit financiar nga shteti shqiptar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar ose të dëbuar në kampe, si një angazhim i shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin për ta të një jete më të mirë. Dëmshpërblimi financiar, sipas këtij ligji, nuk përjashton marrjen e masave të tjera, të njëkohshme ose të mëvonshme, ligjore apo administrative, në dobi të të persekutuarve e të dënuarve politikë, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese apo krijimit të kushteve favorizuese, për riintegrimin shoqëror të tyre. (Neni2, i ligjit).

Ndërsa, objekti i ligjit konsiston në, përcaktimin e përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur persekutimin e drejtpërdrejtë në regjimin komunist, nëpërmjet kryerjes së dënimeve penale të padrejta, si burgim apo masa mjekësore të detyrueshme, si pasojë e një apo disa vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme, gjykatave speciale apo të urdhrave të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991; dëmshpërblimi i familjarëve të viktimave, të ekzekutuara apo të pushkatuara padrejtësisht për motive politike, me vendime penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme apo speciale, ose me urdhra të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991; si dhe dëmshpërblimi financiar për personat e internuar ose të dëbuar, me kusht që humbja e jetës apo periudha e vuajtjes së internimit ose dëbimit të vërtetohen me dokument, të krijuar si burim arkivor para datës 1.10.1991. Ligji nr.9831, datë 12.11.2007 "*Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politike të regjimit komunist*", ka pësuar disa ndryshime dhe konkretisht me ligjin nr. 10111, datë 02.04.2009, ligjin nr. 94/2014, ligjin nr.27/2017 dhe ligjin nr. 57/2018.

Në nenin 4, të ligjit nr. 57/2018, është përcaktuar se: "*Gabimet e bëra në të dhëna ose në përlllogaritjen e masës së dëmshpërblimit , ose ndonjë pasaktësi e dukshme në Vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e dëmshpërblimit financiar, mund të rishikohen me Vendim të Këshillit të Ministrave*".

- **Në lidhje me pretendimin e ankuesit se, dëmshpërblimi financiar si ish i dënuar politik në regjimin komunist është përlllogaritur gabim.**

Ankuesi pretendon se atij i është përlllogaritur gabim dëmshpërblimi financiar si ish i dënuar politik në regjimin komunist, pasi i janë zbritur padrejtësisht vitet e dënimit. Ankuesi pretendon gjithashtu se, nuk është dëmshpërblyer në mënyrë të barabartë, së pari, me personat madhorë, në kushtet kur në kohën e dënimit ai ka qenë i mitur (nuk kishte mbushur 16 vjeç) dhe së dyti, me personat e tjerë të regjimit komunist të cilët kanë përfituar dëmshpërblime në një masë shumë më të lartë se ish të dënuarit politikë, pasi kanë fituar pafajësinë nga gjykatat.

Referuar kuadrit ligjor që rregullon çështjen e dëmshpërblimit financiar të ish të dënuarve politikë në regjimin komunist, rezulton se:

Në bazë të nenit 3, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, në kuptim të këtij ligji, me dënim penal të padrejtë, për efekt të dëmshpërblimit, nënkuptohet dënimi kapital ose çdo ditë heqje lirie, izolimi, internimi apo dëbimi, për vepra penale politike, në institucionet penitenciare apo një institucion mjekësor, psikiatrik apo jopsikiatrik, ndër të tjera, për shkak të një vendimi dënim me burgim.

Për të përfituar dëmshpërblim, në nenin 4, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “ *I dënuari ose familjarët e viktimave të dënuara, të ekzekutuara apo të pushkatuara, për të përfituar dëmshpërblim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) të jetë dënuar me dënim kapital, heqje lirie, internim dhe dëbim apo të jetë izoluar në hetuesi ose në një institucion mjekësor psikiatrik, për shkak të një vendimi gjykate të formës së prerë, të një akti administrativ apo të urdhrave të hetuesisë, të dhëna gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991; b) heqja e lirisë, izolimi në hetuesi apo në një institucion mjekësor psikiatrik, me vendim gjyqësor të formës së prerë apo me urdhër të hetuesisë, të jetë për shkak të një veprë penale politike, siç përcaktohet në nenin 5 të këtij ligji; c) të ketë kryer ose të ketë vuajtur dënim penal të padrejtë plotësisht ose pjesërisht; d) të kenë fituar pafajësinë, sipas ligjit nr. 7541, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar; e) sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, të mos ketë kryer veprime të dëmshme, me pasoja për jetën e shtetasve të tjerë.”*

Në referim të nenit 5, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, veprat penale politike, në kuptim të këtij ligji, vlerësohen vetëm veprat penale të parashikuara në një nga dispozitat ligjore të parashikuara nga ky nen. Në gërmën “dh”, të nenit 5, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet: “*dh) dispozitat e Kodit Penal të vitit 1977, miratuar me ligjin nr.5591, datë 15.6.1977 dhe ndryshuar me ligjin nr. 6300, datë 27.3.1981, të përcaktuar si më poshtë: Neni 47 “Tradhtia ndaj atdheut”.....”*. Në paragrafin e fundit të nenit 5, të ligjit të sipërcituar përcaktohet: “*Kur, në përfundim të një gjykimi, ish i dënuari politik është dënuar me një vendim përfundimtar, të dhënë si bashkim dënimesh, një ose disa prej të cilave janë dënime penale politike të padrejta, në kuptim të këtij ligji, përlllogaritja e pjesës takuese, që zë dënimi politik, për efekt të këtij ligji, në kohën e përgjithshme të vuajtjes së dënimit, të kryhet në përpjesëtim me raportin gjithsej, sipas formulës, që i bashkëlidhet shtojcës “A”. Në të njëjtën mënyrë veprohet në rastet kur bashkimi i dënimeve është dhënë gjatë kohës së vuajtjes së një dënimi të mëparshëm.*

Në Shtojcën A, që i bashkëlidhet ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, bëhen përcaktimet e mëposhtme:

“Shtojca A

*Formula e përlogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit politik të padrejtë, në kuptim të paragrafit të fundit të nenit 5 do të jetë, si vijon:*

$$A = (A / \Sigma) \times Y$$

“A” - *periudha e vuajtjes së dënimit politik, gjithsej në ditë. Ku një vit, është i barabartë me 365 ditë ndërsa një muaj është i barabartë me 31 ditë.*

“A” - *në kuptim të këtij ligji, është masa e dënimeve të dhëna, për një ose disa nga vepra penale politike sipas nenit 5, të këtij ligji e llogaritur në ditë, sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor.*

“Σ” - *në kuptim të këtij ligji, është masa e dënimeve gjithsej e llogaritur në ditë, sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor.*

“Y” - *në kuptim të këtij ligji është koha reale e vuajtjes së dënimit, e cila përfshin edhe periudhën e hetuesisë e për shkak të këtij vendimi gjyqësor. Një vit është i barabartë me 365 ditë. Një muaj është i barabartë me 31 ditë.*

Në bazë të nenit 10, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, Ministria e Drejtësisë është autoriteti përgjegjës që shqyrton kërkesat për përfitimim e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji. Kur pas shqyrtimit administrativ, rezulton se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj, Ministria e Drejtësisë i propozon Këshillit të Ministrave, miratimin e dëmshpërblimit. Këshilli i Ministrave shqyrton propozimet e dërguara nga Ministria e Drejtësisë, brenda dy javëve kalendarike. Vendimet hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

Sipas nenit 11, të po këtij ligji, Ministria e Drejtësisë, gjatë shqyrtimit të kërkesave, bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Shërbimin Informativ të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe arkivat e sistemit gjyqësor. Kriteret, procedurat e bashkërendimit të informacionit dhe lloji i përgjigjes për çdo kërkesë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të këtij parashikimi ligjor, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 189, datë 21.02.2008 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të bashkërendimit të informacionit, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera, përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave për dëmshpërblim të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, si dhe të llojit të përgjegjësisë për çdo kërkesë ”

Masa e dëmshpërblimit për personat që përfitojnë sipas ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, përcaktohet në nenin 6, të këtij ligji, ku parashikohet shprehimisht: “Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë: a) çdo i dënuar politik, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer, në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991, dëmshpërblehet financiarisht, sipas kriterëve të këtij ligji, në masën 2

000 (dy mijë) lekë në ditë; ..... Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme.”

Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesi A.Gj, ka depozituar në datën 27.03.2008, brenda afateve ligjore, kërkesën për dëmshpërblim, e cila është regjistruar në dosjen me nr.4801, datë 27.03.2008. Nëpërmjet shkresës “Relacion “Për kalimin në shqyrtim në themel të kërkesës së z. A.Gj si ish i dënuar politik” me nr.4801/1 prot, datë 31.03.2008, të hartuar nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se, pas shqyrtimit paraprak ka rezultuar se kërkesa e paraqitur nga ankuesi plotësonte kërkesat formale dhe duhet të vazhdonte shqyrtimi në themel i saj. Dosja e ankuesit i është nënshtruar procesit të shqyrtimit dhe verifikimit, në bashkërendim me institucionet e tjera përgjegjëse të ngarkuara nga ligji për përcjelljen e informacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë, fakt ky që rezulton nga aktet shkresore të depozituara nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Pas shqyrtimit administrativ të dosjes, me shkresën nr.4801/8 prot datë 07.09.2009, nëpunësi përgjegjës, i ka propozuar Ministrinë të Drejtësisë, pranimin e kërkesës së ankuesit për dëmshpërblim financiar në masën 2 368 603 lekë, të përlllogaritura për 1446 ditë, pasi është zbritur shuma prej 523 397 lek në letra me vlerë të përfituar nga ankuesi.

Me urdhrin nr.4801/9, datë 07.09.2009 “Për pranimin e kërkesës për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarin e regjimit komunist A.A.Gj”, të Ministrisë të Drejtësisë është urdhëruar: “Pranimin e kërkesës së kërkuesit A.A.Gj për dëmshpërblimin financiar si ish i dënuar politik në masën **2 368 603 lekë**, për kryerjen e dënimit politik të padrejtë me burgim për veprën penale politike “Tradhti ndaj atdheut në formën e arratisjes e mbetur në tentativë” të parashikuar nga neni 47/gj i K.P të vitit 1977. Kjo veprë penale konsiderohet politike për efekte të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 sepse është e listuar në gërmën “dh” të nenit 5 të tij.”

Ankuesi deklaron se ka marrë në total një dëmshpërblim prej 2 360 000 lekë të përfituar me 8 (tetë) këste gjatë periudhës 2010-2018, por nuk ka depozituar ndonjë dokumentacion provues në lidhje me shumën e dëmshpërblimit të përfituar. Ankuesi nuk ka ngritur pretendime në lidhje me këtë moment, që sipas nenit 13, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, është në kompetencë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pretendimet e ankuesit drejtohen kundër Ministrisë së Drejtësisë me pretendimin se, në cilësinë e autoritetit të ngarkuar nga ligji, ka përlllogaritur në mënyrë të gabuar masën e dëmshpërblimit.

Sipas dokumentacionit të administruar rezulton se, ankuesi me vendimin nr. 404, datë 15.10.1986, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dënuar me 5 (pesë) vjet sipas nenit 47/gj për veprën penale politike “Tradhti ndaj atdheut” dhe me 6 (gjashtë) muaj për veprën penale jo politike “Sjellje e padenjë në shoqëri, sipas nenit 129, të Kodit Penal të vitit 1977. Sikurse rezulton nga vendimi gjyqësor, në bashkim të dy dënimeve, përfundimisht gjykata e ka dënuar ankuesin me 5 (pesë) vjet heqje lirie. Rezulton se, ankuesi ka vuajtur 4 (katër) vjet, 4 (katër) muaj dhe 9 (nëntë) ditë burg.

Në përfundim të gjykimit, ankuesi është dënuar nga ana e gjykatës me një vendim përfundimtar prej 5 (pesë) vite burgim, të dhënë si bashkim dënimesh, ku një prej dënimeve penale ka qenë për veprën politike atë të parashikuar nga neni 47/gj, të Kodit Penal të vitit 1977 dhe një për veprën penale jo

politike, të parashikuar nga neni 129, të po këtij Kodi Penal. Në këto kushte, në bazë të nenit 5, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, përlllogaritja e pjesës takuese, që zë dënimi politik, për efekt të ligjit, në kohën e përgjithshme të vuajtjes së dënimit, përlllogaritet sipas formulës që i bashkëlidhet shtojcës A, të këtij ligji.

Nga verifikimi i formulës së parashikuar nga shtojca A, e ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar dhe mënyrës se si është zbatuar ajo në rastin e ankuesit, Komisioneri konstaton vetëm një moskoherencë dhe pasaktësi me 1 ditë, në lidhje me përlllogaritjen e periudhën së vuajtjes së dënimit politik gjithsej. Konkretisht, në relacionin e vitit 2009, janë përlllogaritur 1446 ditë gjithsej si periudhë e vuajtjes së dënimit politik, ndërsa në përlllogaritjet e sjella gjatë shqyrtimit të ankesës masa e dëmshpërblimit përlllogaritet për 1445 ditë gjithsej. Megjithatë, konstatohet se, shuma përfundimtare e dëmshpërblimit, si në relacionin e vitit 2009, urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, ashtu edhe në parashtrimet e sjella nga MD gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk ndryshon, por në të tri rastet është 2 368 603 lekë.

Komisioneri, konstaton se, legjislacioni në fuqi që rregullon çështjen e dëmshpërblimit për ish të dënuarit politik në regjimin komunist, nuk përmban parashikime të posaçme në lidhje me ish të dënuarit politik të cilët në kohën e vuajtjes së dënimit kanë qenë të mitur. Këta të fundit në lidhje me mënyrën dhe masën e përlllogaritjes së dëmshpërblimit financiar trajtohen njëjloj me ish të dënuarit politik të cilët në kohën e dënimit kanë qenë persona madhor.

Komisioneri thekson faktin se, ligji nr.9831, datë 12.11.2007, i ndryshuar, do të kishte qenë në përputhje me parimin e barazisë, nëse do të kishte diferencuar në trajtim të miturit nga madhorët. Referuar Vendimit Nr. 34, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese, diferencimi për shkak të moshës, përbën një përligje të arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të kategorive të caktuara të personave që përfitojnë nga kjo e drejtë.

Sa më sipër, Komisioneri nuk konstaton veprime ose mosveprime nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, të cilat vijnë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.9831, datë 12.11.2017, të ndryshuar, në lidhje me përlllogaritjen e masës së dëmshpërblimit financiar në emër të ankuesit A.Gj. Në këto kushte Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Masa e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politik nuk është lënë në diskrecionin e institucioneve, por është përcaktuar në ligj dhe konkretisht në nenin 6, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar. Për rrjedhojë, çdo pretendim për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të ish të dënuarve politik në lidhje me masën e dëmshpërblimit financiar të përcaktuar në ligjin e sipërcituar, nuk mund të drejtohet ndaj institucioneve të cilat kanë si detyrim të zbatojnë legjislacionin në fuqi në përputhje me kompetencat e tyre.

Çështja e kundërshtuar nga ankuesi, konkretisht në lidhje me masën e dëmshpërblimit financiar që përfiton si ish i dënuar politik, është çështje që rregullohet nga ligji. Në këto kushte, Komisioneri, vlerëson se, pretendimi i ankuesit për trajtim diskriminues si ish i dënuar politike, në lidhje me

masën e dëmshpërblimit që është përcaktuar në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007, i ndryshuar, nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit.

Parimi i shtetit të së drejtës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas të drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore (*shih Vendimin nr. 15, datë 15.04.2010, vendimin nr.22, datë 24.04.2015, vendimin nr. 2 datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007, nr. 11, datë 02.04.2008, vendimi nr. 25, datë 05.12.2008*).

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. (Neni 124, i Kushtetutës). Në referim të nenit 131, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, është institucioni i cili vendos në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është një institucion i ngarkuar nga ligji për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. (neni 21, i LMD) Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit (neni 22, i LMD), ndërsa kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashikohen nga neni 32, i LMD.

Në këtë mënyrë, baza dhe kufiri në ushtrimin e kompetencave për Komisionerin, janë Kushtetuta dhe ligjet në fuqi. Komisioneri ka kompetencë që të shqyrojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar; të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes legjitim, qoftë kur ato pretendojnë diskriminim në emër të një individi ose grupeve të individëve, ashtu edhe kur pretendojnë diskriminim që lidhet me interesa kolektive; të kryejë hetime kryesisht pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; por në çdo rast, ushtrimi i këtyre kompetencave bëhet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Një ligj i cili vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, është një ligj i cili nuk është në përputhje me Kushtetutën, por gjykimin dhe vlerësimin për një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm Gjykata Kushtetuese, si i vetmi autoritet i autorizuar nga Kushtetuta për të vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën. Në rastin objekt shqyrtimi, Komisioneri nuk ka kompetencë që të vlerësojë dhe gjykojë nëse ligji nr.9831, datë 12.11.2007 “*Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist*”, të ndryshuar, vendos në kushte diskriminuese ankuesin, si ish i dënuar politik, në lidhje me masën e dëmshpërblimit financiar të parashikuar.

- **Në lidhje me pretendimin se ankuesit se i është mohuar e drejta për të përfituar pension të posaçëm shtetëror.**

Bazuar në dokumentacionin e administruar rezulton se, ankuesi i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore me një kërkesë, e cila është regjistruar me nr.5881 prot, datë 26.08.2022, lidhur me përfitimin e trajtimit me pension të posaçëm. Me shkresën nr.6165/1 prot, datë 26.07.2023, Instituti i Sigurimeve Shoqërore i ka kthyer përgjigje ankuesit duke e informuar në lidhje me kuadrin ligjor që rregullon përfitimin e pretenduar prej tij dhe duke e berë me dije ankuesin se, ISSH, zbaton dhe administron vendimin e miratuar nga Këshilli i Ministrave për dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror në shumën dhe në kushtet e përcaktuara.

Rezulton gjithashtu e provuar se, në lidhje me këtë kërkim ankuesi i është drejtuar *Platformës së Bashkëqeverisjes*. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 23.03.2023, kjo Platformë i ka kthyer përgjigje ankuesit duke i komunikuar përgjigjen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Referuar përmbajtjes së përgjigjes që i është komunikuar ankuesit nëpërmjet *e-mailit* të datës 23.03.2023, konstatohet se përmbajtja e përgjigjes, rezulton të jetë e njëjtë me atë të shkresës së sipërcituar të ISSH.

Referuar legjislacionit në fuqi që rregullon të drejtën e pretenduar nga ankuesi, pra përfitimin e trajtimit me pension të posaçëm, rezulton se:

E drejta për të përfituar pension të posaçëm shtetëror ose shtesë të pensionit të posaçëm shtetëror mbi pensionin që përfitohet nga sigurimet shoqërore, parashikohet nga neni 5, i ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, ku përcaktohet:

*“Kanë të drejtë për pensione të posaçme që jepen nga shteti personat që:*

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë dhe në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;*
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, sportit ekonomisë dhe politikës;*
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik në regjimin komunist.*

*Personat e përmendur në shkronjat “a”, “b”, “c”, të këtij neni përfitojnë:*

- a) Pension të posaçëm shtetëror, në rast se nuk përfitojnë pension nga sigurimet shoqërore, ose*
- b) Shtesë pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që iu takon nga sigurimet shoqërore.*

*Kushtet e përfitimit, shuma dhe procedura për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.*

*Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë që administrimi i pensioneve të posaçme shtetërore të bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe shpenzimet të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.”*



Në bazë dhe për zbatim të kësaj dispozite ligjore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtresave të pensioneve të posaçme shtetërore”. Ky vendim ka pësuar disa ndryshime ndër vite dhe konkretisht me Vendimet nr.730, datë 02.09.2015 dhe nr. 374, datë 21.06.2023, të Këshillit të Ministrave.

Në VKM nr.429, datë 12.09.2002, të ndryshuar, bëhen rregullimet dhe përcaktimet e mëposhme në lidhje me procedurën e dhënies së pensionit të posaçëm shtetëror ose të shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror.

*“4. Kërkesa për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror bëhet nga i interesuari ose nga organizatat a shoqatat, nëpërmjet këshillit të qarkut të vendbanimit të personit të propozuar, ministrave përkatës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit ose Presidentit.*

*Këshilli i qarkut, Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti, pasi shqyrtojnë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, i propozojnë Këshillit të Ministrave, me vendim të argumentuar, dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror. Vendimi i paraqitet Këshillit të Ministrave, së bashku me dokumentacionin që kërkohet sipas këtij vendimi. Kur kërkesa nuk vlerësohet si e drejtë, i kthehet kërkuarit, e shoqëruar me argumentet përkatëse.*

*Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti mund të propozojnë drejtpërdrejt, me nismën e tyre, pavarësisht nga mosparaqitja e kërkesës së të interesuarit, dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror, personave që vlerësohen se plotësojnë kriteret ligjore.*

.....

*7. Për shqyrtimin e dokumentacionit për pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror ngrihet një komision i veçantë. Përbërja dhe rregullorja e funksionimit të këtij komisioni miratohen nga Kryeministri. Komisioni përgatit relacion për plotësimin ose jo të kushteve të përcaktuara me ligj dhe me këtë vendim dhe ia paraqet Kryeministrit.*

*8. Pensioni, data e fillimit të pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror caktohen me vendim individual të Këshillit të Ministrave.*

*9. Pensioni i posaçëm shtetëror ose shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror indeksohen sa herë dhe në masën që indeksohen pensionet e pleqërisë, të përfituara nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993.*

*10. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore. Në buxhetin e sigurimeve shoqërore, çdo vit, parashikohen fonde për 10-15 pensione të posaçme shtetërore ose shtesa pensionesh të posaçme shtetërore.”*

Nga tërësia e akteve të administruara gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, nuk rezulton që ankuesi të ketë paraqitur kërkesë për përfitimin e të drejtës së pretenduar, atë të pensionit të posaçëm shtetëror, në një nga mënyrat e përcaktuara nga pika 4, e VKM-së nr.429, datë 12.09.2002, të ndryshuar. Korrespondenca që ankuesi ka patur në lidhje me pretendimin për të përfitur pension të posaçëm

shtetëror është shkresa drejtuar ISSH dhe korrespondenca me Platformën e Bashkëqeverisjes. Sipas VKM-së së sipërcituar, procedura pranë Këshillit të Ministrave për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror, fillon në bazë të propozimit të një prej institucioneve që përcaktohen shprehimisht në këtë vendim.

Në kushtet kur nuk ka ndonjë procedurë të iniciuar sipas përcaktimeve të VKM nr.429, datë 12.09.2002, të ndryshuar, Komisioneri nuk mund të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e Këshillit të Ministrave.

Nga ana tjetër, Komisioneri duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 5, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kushtet dhe procedurën e parashikuar sipas VKM-së nr.429, datë 12.09.2002, të ndryshuar, për dhënien e pensioneve të posaçme, vlerëson se, e drejta e përfitimit të pensionit të posaçëm shtetëror, nuk është një e drejtë individuale që mund të kërkohej në rrugë institucionale.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Ministria e Drejtësisë, sugjeroi ankuesin, lidhur me mundësinë e përfitimit nga skema e pensionit për ish të dënuarit politikë, të cilët gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit kanë punuar në miniera nëntokë, sipas ligjit nr.24/2018 “Për disa shtesa në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për Pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar.

Në nenin 1, të ligjit nr.24/2018 “Për disa shtesa në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për Pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar, përcaktohet: “Koha e vuajtjes së dënimit të ish të dënuarve politikë në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë, për efekt pensioni, njihet si punë e kryer në minierë në nëntokë. Periudha njihet sa dyfishi i periudhës së qëndrimit në këto burgje. Paga llogaritet sa paga e punës në minierë në nëntokë, sipas legjisllacionit përkatës. Vërtetimi për kohën e vuajtjes së dënimit në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë lëshohet nga Ministria e Brendshme, pas konfirmimit nga Ministria e Drejtësisë.”

Me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioneri me shkresën nr. 929 prot., datë 08.08.2023, i'u drejtua për një mendim të specializuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), lidhur me kushtet dhe kriteret për të përfituar sipas ligjit të sipërcituar dhe mundësinë e marrjes së përfitimeve të parashikuara sipas ligjit të sipërcituar në rastin e ankuesit.

Referuar informacionit të vendosur në dispozicion nga ISSH, nëpërmjet shkresës nr.6165/3 prot. datë 17.08.2023, konstatohet se, për të përfituar sipas ligjit të sipërcituar, duhet që ish i dënuari politik, i cili gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit ka punuar në miniera, të plotësojë edhe kriteret për të përfituar sipas ligjit të posaçëm që rregullon pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe konkretisht ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”. Për të përfituar sipas këtij ligji, personi që ka punuar në miniera në nëntokë duhet të plotësojë këto kushte : mosha 55 vjeç dhe periudhë e përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 12 vjet e 6 muaj, në procese pune në miniera, në nëntokë. Kriteri i

moshës, i cili është një kriter që mund të konstatohet lehtësisht, rezulton se nuk plotësohet aktualisht nga ankuesi, i cili është i datëlindjes 03.10.1970. Për kriteret e tjera ligjore, në një moment të mëvonshëm, pasi ankuesi të plotësojë moshën e kërkuar nga ligji, duhet t'i drejtohet strukturave përkatëse të ISSH, për të vlerësuar nëse ankuesi i plotëson apo jo kushtet, për të përfituar sipas nenit 1, të ligjit nr.24/2018.

Skemat e tjera të pensioneve apo shtesave mbi pension, nga të cilat ankuesi potencialisht mund të jetë përfitues, të trajtuara në shkresën nr.6165/3 prot datë 17.08.2023, konstatohet se janë të lidhura në radhë të parë me plotësimin e kriterit moshë, për përfitimin e pensionit të pleqërisë, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi A.Gj nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave, në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit A.Gj, për “çdo shkak tjetër” si ish i burgosur politik, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Çdo shkak tjetër/statusi si i burgosur politik  
Fusha: Të mira dhe shërbime  
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim